



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina



Bazuar në dispozitat e nenit 12, paragrafi 12.2, pika d, nenit 40, paragrafi 40.2, pika d të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008), dispozitat e nenit 34, paragrafi 34.1, pika d e Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110 - 391 të dt. 25.2.2010, dhe propozimit të Grupit punues për hartimin e planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2017, të dt. 27.03.2017, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 31.03.2017, miratoi

P L A N I N

VJETOR TË PUNËS SË KUVENDIT TË KOMUNËS

I.

MIRATOHET Plani vjetor i punës së Kuvendit të Komunës së Prishtinës për vitin 2017.

II.

Plani vjetor i cekur në pikën I të këtij vendimi, përmban: numrin e mbledhjeve, muajin në të cilin do të mbahet mbledhja e Kuvendit të Komunës dhe pikat - temat orientuese që do të shqyrtohen nga ana e Kuvendit të Komunës.

III.

Plani vjetor i punës së Kuvendit të Komunës me përmbajtjen e cekur në pikën II të këtij vendimi, është si në vijim:

1. Mbledhja I, muaji janar:

- Propozimplani vjetor i punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2017;
- Informatë e Kryetarit të Komunës për Planin e Punës së Ekzekutivit për vitin 2017;
- Raporti i Kryetarit të Komunës për situatën ekonomiko-financiare dhe për zbatimin e planeve investuese të Komunës për periudhën Korrik - Dhjetor 2016;
- Informatë për Raportin për vlerësimin e performancës së Komunës (nga Drejtoria e Administratës).

Akivitetet

- Debati publik me qytetarë

2. Mbledhja II, muaji shkurt:

- Informatë për suksesin e nxënësve në gjysmëvjetorin e parë;
- Informatë për procesin e trajtimit të ndërtimeve ilegale;
- Informatë për aktivitet e Komunës në funksion të zhvillimit ekonomik;
- Informatë për gjendjen aktuale në Bibliotekën publike "Hivzi Sylejmani" pas transferimit në objektin e ri;
- Informatë për gjendjen dhe funksionimin e Tregut të madh të gjelbër.

Aktivitetet

- Mbledhje solemne me rastin e ditës së shpalljes së pavarësisë së Kosovës

3. Mbledhja III, muaji mars:

- Shqyrtimi i Raportit final financiar të Komunës për vitin 2016;
- Bartja e buxhetit të pashpenzuar të të hyrave vetanake nga viti 2016 në vitin 2017;
- Shqyrtimi i raporteve të komisioneve komunale të aksionarëve të NPL - ve për vitin 2016;
- Propozimvendimi për dhënin në shfrytëzim dhe këmbimin e pronave të paluajtshme të komunës;
- Informatë për sigurinë në shkollat e Komunës;
- Informatë për punën e Drejtorisë së Inspektionit.

➤ *Pikat e pa shqyrtuara të mbledhjes së parë dhe të dytë të Kuvendit, do të shqyrtohen në muajt në vijim.*

4. Mbledhja IV, muaji prill:

- Shqyrtimi i raportit financiar tremujor për periudhën janar - mars 2017;
- Miratimi, ndryshimi dhe plotësimi i akteve normative;
- Informatë për mbjelljet pranverore;
- Informatë për funksionimin e transportit lokal;
- Informatë për përkrahjen dhe motivimin e të rinjve në aktivitete kulturore - artistike, si dhe zbulimi i talentve të rinj.

5. Mbledhja V, muaji maj:

- Formimi i grupit punues për hartimin e planit të veprimit për proces transparent të buxhetimit;
- Informatë për Qarkoren e parë buxhetore të MF-së;
- Informatë për rendin dhe qetësinë në komunë (Policia e Kosovës);
- Informatë për gjendjen e furnizim me ujë (Kompania e ujësjellësit rajonale "Prishtina" SH.A.);
- Informatë për mbledhjen e mbeturinave në Komunë;

- Informatë për gjendjen e sportit dhe kulturës në Komunën e Prishtinës.

6. Mbledhja VI, muaji qershor:

- Rishikimi i buxhetit për vitin 2017;
- Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore për periudhën 2018 – 2020;
- Informatë për menaxhimin e hapësirave publike dhe parqeve në Komunë;
- Diskutimi për arsimin në Komunën e Prishtinës;
- Informatë për përgatitjen e korrje-shirjeve për kulturat bujqësore – drithërat e bardha.
- Diskutim për zhvillim dhe sizajnimin e brendit të Komunës së Prishtinës.

Aktivitetet

- Dëgjimet publike rreth Kornizës Afatmesme Buxhetore 2018 – 2020;
- Mbledhje solemne me rastin e ditës së çlirimit të Prishtinës

7. Mbledhja VII, muaji korrik:

- Raporti i Kryetarit të Komunës për situatën ekonomiko-financiare të Komunës dhe për zbatimin e planeve investuese të Komunës në periudhën Janar – Qershor 2017
- Shqyrtimi i raportit financiar tremujor për periudhën prill – qershor 2017
- Shqyrtimi i Raportit të Auditorit të Përgjithshëm për Komunën për vitin 2016
- Informatë për realizimin e Planit Vjetor të Prokurimit Publik 2017
- Informatë për Raportin për vlerësimin e performancës së Komunës (nga Drejtoria e Administratës)

Aktivitetet

- Debati publik me qytetarë

8. Muaji gusht:

Pushim

Aktivitetet

- Organizimi i dëgjimeve publike rreth buxhetit të Komunës për vitin 2017

9. Mbledhja VIII, muaji shtator:

- Shqyrtimi i projektbuxhetit të Komunës për vitin 2018;
- Shqyrtimi i projektregullores për tatimin në pronën e paluajtshme për vitin 2018;
- Shqyrtimi i projektregullores për tarifa, ngarkesa dhe gjoha komunale për vitin 2018;

- Informatë për suksesin e nxënësve, përfundimin e vitit shkollor 2016/2017 dhe fillimin e vitit shkollor 2017/2018;
- Informatë për përfundimin e procesit të korrje-shirjeve;
- Informatë për ofrimin e ndihmave me artikuj të ndryshëm familjeve në gjendje të rënda sociale në prag të stinës së dimrit.

Aktivitetet

- Organizimi i dëgjimeve publike rreth buxhetit të Komunës për vitin 2018

10. Mbledhja IX, muaji tetor:

- Shqyrtimi i raportit financiar tremujor për periudhën korrik - shtator 2017;
 - Informatë për ndarjen e bursave për studentë;
 - Informatë rreth mbjelljeve vjeshtore;
 - Informatë për fillimin e ngrohjes për sezonin dimëror;
 - Informatë për ndarjen e subvencioneve në bujqësi, sasia e sipërfaqeve dhe lloji i kulturave të mbjella;
 - Informatë për gjendjen në shëndetësi;
 - Informatë për gjendjen e pyjeve në Komunë;
 - Informatë për integrimin e komuniteteve pakicë me komunitetin shumicë në mjediset e përziera.
- *Viti 2017, është vit i zgjedhjeve, andaj muaji nëntor dhe muaji dhjetor, me plan ka paraparë pikat që janë obligative bazuar në mandatin e ri të Kryetarit të Komunës së Prishtinës dhe Kuvendit të Komunës:*

Mbledhja inauguruese, muaji nëntor;

- Fjala e mirëseardhjes dhe kryesimi i mbledhjes nga anëtari më i moshuar i Kuvendit të Komunës;
- Betimi i anëtarëve të Kuvendit të Komunës;
- Betimi i Kryetarit të Komunës (nëse është zgjedhur)
- Fjala përshëndetëse e Kryetarit të Komunës.

Mbledhja e I, muaji dhjetor

- Miratimi i procesverbalit;
- Zgjedhja e Kryesuesit të Kuvendit të Komunës;
- Themelimi i Komitetit për Politikë dhe Financa;
- Caktimi i grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2018;
- Prpozimvendimi për zbatimin e dispozitave të pagave për stafin politik.

IV.

Për zbatimin e pikës III të këtij vendimi do të kujdesen: Kryesuesi i Kuvendit, Kryetari i Komunës, drejtorët e drejtorive, drejtorët e institucioneve shëndetësore dhe arsimore dhe Komisioni komunal i aksionarëve për ndërmarrjet publike lokale.

V.

Ky plan hyn në fuqi 15 ditë nga dita e protokolimit në Njësinë për administrimin e dokumentave të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në web faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS

01. nr.020/06-0074178/17, me 03.04.2017



KRYESUESI I KUVENDIT
Halim Halimi / jur. i dipl.

A r s y e t i m

Kuvendi i Komunës funksionon në bazë të Ligjit për vetëqeverisje lokale, ligjeve dhe akteve të tjera nënligjore që rregullojnë vetëqeverisjen lokale, dhe në bazë të Statutit të Komunës së Prishtinës.

Sipas LVL - së, Kuvendi i Komunës nuk e delegon përgjegjësinë e tij lidhur me marrjen e Vendimit për planin vjetor të punës së tij (neni 40, paragrafi 40.1, pika d).

Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e mbajtur më 21.12.2016, ka themeluar Grupin punues për hartimin e propozimplanit të Kuvendit të Komunës për vitin 2017.

Grupi punues ka mbajtur takim më 27.03.2017 dhe pas finalizimit të këtij propozimplani, i njëjti i dërgohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratimin e tij.